



**ODA
E FARMACISTËVE
TË KOSOVËS**

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVO | KOMORA FARMACEUTIA KOSOVAR



Republika e Kosovës
Republika e Kosovës - Republic of Kosovo

Odha e Farmacistëve të Kosovës
Komora Farmaceutia Kosovare
Chamber of Pharmacists of Kosovo

№ 275 D. 30/12/24

RREGULLORE

PËR ZGJEDHJEN DHE SHKARKIMIN E ANËTARËVE TË ORGANEVE TË OFK-SË

Prishtinë, 2024

KUVENDI I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS në mbështetje të Nenit 19, paragrafi 1 me nënparagrafin 1.1, 1.17 dhe 1.18 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 17, paragrafi 4, Nenit 20, paragrafi 4, Nenit 21, paragrafi 1 me nënparagrafin 1.1 dhe 1.22, të Statutit të Odës së Farmacistëve të Kosovës nr. 134 të datës 04/06/2024, në ribledhjen e datës 14/12/2024 miraton këtë:

RREGULLORE

PËR ZGJEDHJEN DHE SHKARKIMIN E ANËTARËVE TË ORGANEVE TË OFK-SË

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë dhe përcaktojë të drejtat zgjedhore, procedurat, kushtet, kriteret, kompetencat dhe përgjegjësitë në procesin e zgjedhjeve të brendshme të organeve përfaqësuese të OFK-së, si dhe shkarkimin e tyre

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet në procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të organeve përfaqësuese të OFK-së, si organe individuale apo kolegjiale të cilat zgjedhen drejtpërdrejt nga anëtarët e OFK-së apo nga Kuvendi i OFK-së.

Neni 3 Përkufizimet

Për qëllim të kësaj rregullore, termer e përdorura kanë këto kuptime:

“KQZ” – Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, përgjegjës për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në OFK

“KNJZ”- Komisioni i njësisë zgjedhore, përgjegjës për administrimin e procesit në njësi zgjedhore

“Njësi Zgjedhore” – baza zgjedhore e përfaqësimit të anëtarit në Kuvendin e OFK-së, që themelohet në kuadër të regjionit

“Lista Votuese” – lista me të dhënat e anëtarit të OFK-së të cilët kanë të drejtë votimi për Kuvendin e OFK-së

“Anëtar” – Anëtar i OFK-së

“Vëzhgues” – personi i certifikuar nga KQZ për të monitoruar procesin zgjedhor

“Organizatë e akredituar” – organizatë jo qeveritare sikurse edhe organizatat ndërkombëtare të specializuara të cilat merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut e të cilat akreditohen nga KQZ për monitorimin e procesit zgjedhor për Kuvendin e OFK-së

“Libri Votimit” – forma, material zgjedhor i aprovuar nga KQZ në të cilin shënohen vërejtjet përkitazi me procesin zgjedhor pranë OFK

“Formulari i Përputhjes së Rezultateve” (FPR) do të thotë formulari i miratuar nga KQZ-ja para çdo zgjedhjeve për qëllim të përputhjes së votave në një vendvotim;

“Periudha e kundërshtimit dhe e konfirmimit” do të thotë periudha kohore pas shpalljes së listës

preliminare të votuesve, gjatë së cilës votuesit me të drejtë vote mund të kundërshtojnë pasaktësitë ose lëshimet në Listën e Votuesve në vendet e caktuara nga KQZ-ja dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat e themeluara nga KQZ-ja;

"SKQZ" do të thotë Sekretariati i KQZ-së;

"Vendvotimi" (VV) do të thotë një dhomë, sallë ose objekt i ngjashëm për qëllim të votimit në Ditën e Zgjedhjeve

Pezullim i mandatit- humbja e përkohëshme e të drejtave dhe benificioneve nga pozita deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar apo vendosjes nga kuvendi

Revokim i anëtarit – mënyra e humbjes së mandatit të anëtarit të organeve sipas mënyrës së përcaktuar me këtë Statut dhe këtë rregullore

Neni 4

Shpallja e zgjedhjeve

1. Kuvendi i OFK-së cakton dhe shpall datën e zgjedhjeve për Kuvendin e OFK-së.
2. Zgjedhjet për Kuvendin e OFK-së nuk mbahen më herët se gjashtëdhjetë (60) ditë para përfundimit të mandatit të legjislaturës përkatëse.
3. Vendimi i Kuvendit për të caktuar datën e zgjedhjeve bëhet jo më herët se gjashtë (6) muaj dhe jo më vonë se 1 (një) muaj para datës së zgjedhjeve. Dita e zgjedhjeve për Kuvend caktohet në ditë vikendi (e shtunë, e diele)
4. Kuvendi i OFK-së zgjedhet për një mandat katër (4) vjeçar, i cili fillon që nga dita e seancës konstitutive e cila mbahet brenda tridhjetë (30) ditësh nga shpallja zyrtare e rezultateve të zgjedhjeve.
5. Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve bëhet publik në ëeb faqen e OFK-së.

Neni 5

Zgjedhjet e jashtëzakonshme

Zgjedhjet e jashtëzakonshme do të mbahen dhe organizohen nga KQZ-ja sipas procedurës për mbajtjen e zgjedhjeve të rregullta që janë të parapara me këtë rregullore, në afat jo më herët se tridhjetë (30) ditë dhe jo më vonë se dyzetë (40) ditë nga shpërndarja e Kuvendit.

Neni 6

Parimet Themelore

1. Zgjedhjet për Kuvendin e OFK-së mbahen në bazë të votës së lirë, të përgjithshme, të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë në përputhje me këtë rregullore dhe Statutin e OFK-së.
2. Votuesit me të drejtë vote janë të barabartë në ushtrimin e të drejtës së tyre për të votuar
3. Çdo anëtar i OFK-së ka të drejtën për të votuar dhe për t'u zgjedhur pa diskriminim në bazë të racës, etnisë, ngjyrës, gjuhës, gjinisë, besimit fetar apo bindjes politike, arsimit, përkatësisë sociale apo ndonjë kriteri tjetër të ngjashëm në përputhje me dispozitat e Statutit dhe të kësaj rregullore.
4. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ndërmerri aktivitete për edukimin e votuesve me qëllim të rritjes së aftësive të votuesve për procedurat e votimit dhe procedurat e mbrojtjes së të drejtave zgjedhore.
5. Liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar. Askush nuk ka të drejtë të pengojë ndonjë anëtar për të votuar, të detyrojë atë të votojë në një mënyrë të caktuar, të mbajë atë përgjegjësi për votën, ose të kërkojë kundër dëshirës së tij/saj që të zbulojë votën e tij/saj ose arsyet për mos votim.
6. Zgjedhjet për Kuvendin e OFK-së reflektojnë përfaqësimin gjeografik të të gjitha rajoneve të Kosovës
7. Të gjitha kandidatët, mbështetësit e tyre dhe të gjitha institucionet tjera janë të obliguara të respektojnë parimet themelore të përcaktuara në këtë nen dhe të ndërmarrin të gjitha masat për të siguruar mbajtjen e zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të mirë-informuara në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

KREU II **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Neni 7 **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, është organ i përhershëm i OFK-së me mandat 4 vjeçar dhe i pavarur. KQZ-ja siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me Statutin e OFK-së dhe kësaj rregullore.
2. KQZ është e vendosur në selinë e OFK-së.
3. KQZ ka vulën e saj autentike, përmbajtja, forma, dimensionet dhe mënyra e përdorimit të vulës përcaktohen me vendim të KQZ-së. KQZ ka protokoll të veçantë.

Neni 8 **Përbërja dhe mandati i KQZ-së**

1. KQZ përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i OFK-së me propozimin e Këshillit Drejtues.
2. Anëtarët e KQZ-së kanë mandat 4 (katër) vjeçar nga dita e zgjedhjes së tyre dhe deri në përfundimin e procedurës së zgjedhjes së anëtarëve me mandat të ri. Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të KQZ-së duhet të fillojë 15 ditë (pesëmbëdhjetë) para skadimit të mandatit të anëtarëve ekzistues të zgjedhur të KQZ-së.
3. Deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj të KQZ-së, anëtarët e mandatit ekzistues do të ushtrjnë kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre.
4. Anëtarët e KQZ-së mund të zgjedhen vetëm për dy mandate me radhë të njëpasnjëshëm dhe të njëjtit nuk mund të jenë kandidatë për anëtarë të organeve të cilat zgjedhen me kandidim në Kuvend.
5. Anëtarët e zgjedhur të KQZ-së nuk mund të mbështesin me nënshkrim asnjë kandidat për anëtar të Kuvendit të OFK-së.

Neni 9 **Kompetencat dhe përgjegjësitë e KQZ-së**

1. KQZ-ja në pajtim me këtë rregullore ka këto përgjegjësi:
 - 1.1. siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve dhe shkarkimit në pajtim me Statutin e OFK-së dhe këtë rregullore;
 - 1.2. përgatitjen, mbikëqyrjen, drejtimin dhe verifikimin e të gjitha veprimeve që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve dhe shkarkimit të anëtarëve të organeve të OFK-së;
 - 1.3. përgatitjen dhe miratimin e planit të veprimit dhe përcaktimin e detyrave të veçanta;
 - 1.4. përcaktimin e afateve kohore në ekzekutimin e planit të veprimit dhe monitorimin e zbatimit të tij;
 - 1.5. emërimin e komisioneve të njësisë zgjedhore;
 - 1.6. mbikëqyrjen e punës së KNJZ-ve dhe veprimeve përgatitore në procesin zgjedhor;
 - 1.7. miraton formën dhe dizajnin e fletë votimit;
 - 1.8. certifikimin e listës së votuesve;
 - 1.9. certifikimin e kandidatëve për organe të OFK-së;
 - 1.10. certifikimin rezultativ zgjedhor dhe shqyrtimin e ankesave zgjedhore të parashtruara nga palët;
 - 1.11. trajnimin dhe sigurimin e materialit zgjedhor për KNJZ-të;
 - 1.12. Verifikimin e listave inicuese për ngritjen e procedurës së shkarkimit/Shkarkimit të anëtarëve të Kuvendit apo Kuvendit

- 1.13. Nxjerr akte tjera dhe kryen edhe detyra të ndryshme në realizim të zgjedhjeve të organeve të OFK-së në përputhje me dispozitat e kësaj rregullore dhe statutin e OFK-së.
- 1.14. Jashtë procesit të rregullt zgjedhor mbledhjet e KQZ-së thirren me kërkesën e kryetarit të OFK-së sipas nevojës konkrete për çështje nga fushëveprimi i kësaj rregullore.
- 1.15. Çështjet tjera të mbarëvajtjes së punës të KQZ-së rregullohen përshtatshmërisht me rregulloren për punën e organeve kolegjiale të OFK-së.

Neni 10

Kompetencat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të KQZ-së

1. Anëtarët e KQZ-së kanë këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - 1.1. kujdesen për zbatimin e kësaj rregullore dhe akteve të tjera të nxjerra nga KQZ-ja;
 - 1.2. marrin pjesë në mbledhjet e KQZ-së dhe japin propozimet e tyre lidhur me çështjet që trajtohen në mbledhjet e KQZ-së;
 - 1.3. kryejnë detyrat e përcaktuara nga KQZ-ja dhe ndërmarrin veprimet e përcaktuara sipas planit të miratuar të veprimit;
 - 1.4. propozojnë plotësimin dhe ndryshimin e rendit të ditës;
 - 1.5. njoftojnë kryesuesin dhe arsyetojnë për mos pjesëmarrje në mbledhje;
 - 1.6. përmbahet dhe deklarohet në rast se dyshon lidhur me ekzistimin e ndonjë rrethane të konfliktit të interesit dhe kryejnë veprime të tjera brenda fushëveprimit të KQZ-së.
2. Anëtari i KQZ-së është i obliguar që mungesën e tij në mbledhjen e ardhshme të thirrur të KQZ-se ta arsyetojë. Në rast të tri mungesave të paarsyeshme, anëtarit të KQZ-së i përfundon mandati.

Neni 11

Kryesuesi i KQZ-së

1. Kryesuesi i KQZ-së zgjedhet nga Këshilli Drejtues, dhe është një nga anëtarët e KQZ-së të propozuar nga Këshilli
2. Kryesuesi i KQZ-së ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - 2.1. Përfaqëson KQZ-në;
 - 2.2. Thërret mbledhjet e KQZ-së dhe propozon rendin e ditës;
 - 2.3. Kryeson mbledhjet dhe kujdeset për mbarëvajtjen e saj;
 - 2.4. Kujdeset për zbatimin e drejtë të kësaj rregullore, vendimeve, akteve të tjera të KQZ-së dhe akteve normative të OFK-së brenda fushëveprimit të KQZ-së;
 - 2.5. Siguron transparencën e akteve që i nxjerr KQZ-ja;
 - 2.6. Nënshkruan vendimet dhe aktet të tjera të miratuara nga KQZ-ja;
 - 2.7. Kryen dhe ndërmerr veprimet të tjera të nevojshme për funksionalitetin e KQZ-së.
3. Në rast të pamundësisë së ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të përcaktuara nga paragrafi 2 i këtij neni, të njëjtat do të ushtrohen nga zëvendëskryesuesi i KQZ-së.

Neni 12

Zëvendëskryesuesi i KQZ-së

1. Zëvendëskryesuesi i KQZ-së zgjedhet nga radhët e anëtarëve të KQZ-se me propozim të kryesuesit të KQZ-së.
2. Zëvendëskryesuesi i KQZ së zgjedhet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të KQZ-së.
3. Zëvendëskryesuesi i ushtron kompetencat e Kryesuesit në rast të mungesës së tij.
4. Në rast të mungesës të Kryesuesit dhe Zëvendëskryesuesit, mbledhjet i kryesom anëtari në moshën më të vjetër në radhët e anëtarëve të KQZ-së.

Neni 13

Mbledhjet e KQZ-së

1. KQZ-ja mbanë mbledhjet e rregullta të paktën një herë në dy javë nga shpallja e zgjedhjeve të OFK-së. Jashtë procesit të shpallur zgjedhor mbledhjet thirren sipas nevojës konkrete në kuadër të fushëveprimit dhe kompetencave të KQZ së.
2. Mbledhjet e rregullta i thërret Kryesuesi me propozim të rendit të ditës për mbledhjen e thirrur.
3. Rendi i ditës dhe materiali përcjellës i dërgohet anëtarëve të KQZ-së së bashku me ftesën për mbledhje.
4. Ftesa dhe materiali nga paragrafi 3 i këtij neni duhet t'u dërgohen anëtarëve të KQZ-së së paku 24 orë para mbledhjes së thirrur.
5. Në pamundësi të thirrjes së mbledhjes nga Kryesuesi, mbledhja e rregullt mund të hirret edhe nga Zëvendëskryesuesi. Termi pamundësi interpretohet përshatshmërisht me përkufizimin e përcaktuar në Statut.
6. Mbledhjet e jashtëzakonshme të KQZ-së mund të thirren me kërkesën e të paktën 2 (dy) anëtarëve të KQZ-së. Detyrimet lidhur me paragrafet 3 dhe 4 të këtij neni nuk janë të zbatueshme me rastin e thirrjes së mbledhjes së jashtëzakonshme.
7. Për të gjitha mbledhjet e KQZ-së përpilohen procesverbalet të cilat po ashtu ruhen në arkivin e KQZ-së. Procesverbalet e mbledhjes së mbajtur të KQZ së miratohen në mbledhjen e radhës.
8. Për të gjitha çështjet që nuk janë paraparë me dispozitat e kësaj rregullore, atëherë janë të zbatueshme dispozitat e Rregullores për punën e organeve kolegjiale të OFK-së.

Neni 14

Kuorumi dhe vendimmarrja

1. KQZ-ja ka kuorum kur janë të pranishëm të paktën dy (2) anëtarë të KQZ-së.
2. Para çdo vendimmarrje Kryesuesi i mbledhjes duhet të konstatojë kuorumin e mbledhjes.
3. Vendimet e KQZ-së merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të KQZ-së.
4. Në rastet kur numri i votave për dhe kundër janë të barabarta, vota e Kryesuesit të mbledhjes është vendimtare.
5. Në çdo pikë të rendit të ditës, Kryesuesi e hap diskutimin, e hedh në votim dhe konstaton përmbajtjen e vendimit dhe rezultatin e vendimit.
6. Në rast të ekzistimit të konfliktit të interesit, anëtari i KQZ-së ka për obligim që të vetëdeklarohet dhe të tërhiqet nga procedura e votimit. Në rast të mosdeklarimit të anëtarit lidhur me ekzistimin e konfliktit të interesit, rrethana e tillë mund të denoncohet nga secili anëtar i KQZ-së.
7. Në rast të denoncimit të tillë Kryesuesi i mbledhjes e hudhë në votim denoncimin e arsyetuar.
8. Në rast të vetë deklarimit apo denoncimit të ekzistimit të konfliktit të interesit, anëtari që konsiderohet se gjendet në rrethana të tilla, përjashtohet nga shqyrtimi dhe votimi i çështjes për të cilën duhet vendosur.

Neni 15
Votimi në mbledhje

1. Votimi në mbledhjet e KQZ-së është i hapur.
2. Përfundimisht votimi është i fshehtë në rast se ka të bëjë me zgjedhjen e individit për një funksion të caktuar.
3. Forma e votimit bëhet përmes votës PËR, KUNDËR dhe ABSTENIM.
4. Vendimet e KQZ-së së mund të merren edhe në procedurë qarkulluese.
5. Procedura qarkulluese është procedurë e votimit, në të cilën anëtarët votojnë individualisht, me shkrim, pa qenë e nevojshme mbledhja e KQZ-së.

Neni 16
Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretariatit të KQZ-së

1. Sekretariati i KQZ së është shërbim administrativ i KQZ-së që në kuadër të funksioneve dhe përgjegjësi, ndihmon KQZ-në në zbatimin e procesit zgjedhor në pajtim me këtë rregullore dhe akteve të tjera normative të OFK-së.
2. Sekretariati i KQZ së ushtron këto funksione:
 - 2.1. Bënë njoftimin e anëtarëve të KQZ-së për mbledhjet e thirrura në pajtim me këtë rregullore;
 - 2.2. Përgatitë dhe dërgon materialin e nevojshëm;
 - 2.3. Merr pjesë në ekzekutimin e planit të veprimit të miratuar nga KQZ-ja;
 - 2.4. Kryen të gjitha veprimet që i besohen nga KQZ-ja lidhur me procesin zgjedhor;
 - 2.5. Ofron mbështetje logjistike për nevojat e mbarëvajtjes së procesit zgjedhor;
 - 2.6. Koordinon shpërndarjen dhe mbledhjen e materialit zgjedhor në afatet e përcaktuara me Planin e Veprimit;
 - 2.7. Siguron mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve si dhe evidencën e pjesëmarrjes në mbledhje;
 - 2.8. Kryen punët të tjera sipas nevojës.
3. Sekretariati i KQZ-së mund të propozojë KQZ-së çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me çështjet operacionale të procesit zgjedhor dhe të propozojë që çështjet të tilla të shqyrtohen në mbledhjen e KQZ-së.

Neni 17
Përbërja e Sekretariatit të KQZ-së

1. Sekretariati i KQZ-së përbëhet nga zyrtarët e Shërbimit Profesional të OFK-së.
2. Sekretariatit të KQZ-së sipas nevojës mund t'i caktohet anëtar shtesë me miratimin e Këshillit Drejtues të OFK-së.
3. Sekretariati i KQZ-së është bartës i detyrave dhe përgjegjësi gjatë gjithë kohës sa zhvillohet procesi zgjedhor.
4. Dispozitat e paragrafit paraprak zbatohen përshtatshëmrisht edhe gjatë organizimit të zgjedhjeve të parakohshme për ndonjërin nga organet e OFK-së.

Neni 18 Njësitë Zgjedhore

1. Njësitë zgjedhore përbëhen si më poshtë:

- 1.1. Njësia zgjedhore e rajonit të Prishtinës: Prishtinë, Podujevë, Obiliq, Lipjan, Fushë Kosovë, Gracanicë, Drenas
- 1.2. Njësia zgjedhore e rajonit të Prizrenit: Prizren, Suharekë, Malishëve, Dragash, Mamushë.
- 1.3. Njësia zgjedhore e rajonit të Pejës: Pejë, Klinë, Istog
- 1.4. Njësia zgjedhore e rajonit të Gjakovës: Gjakovë, Decan, Rahovec, Junik
- 1.5. Njësia zgjedhore e rajonit të Gjilanit: Gjilan, Kamenicë, Novobërd Klllokot, Partesh, Ranilluk.
- 1.6. Njësia zgjedhore e rajonit të Ferizajt: Ferizaj, Shtime, Kaçanik, Shtërpeç, Hani i Elezit.
- 1.7. Njësia zgjedhore e rajonit të Mitrovicës: Mitrovicë, Vushtri, Skenderaj, Mitrovica e Veriut, Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok.

2. KQZ-ja nxjerrë vendim për të përcaktuar:

- 2.1. Qendren e votimit në Njësinë Zgjedhore;
- 2.2. Numrin e anëtarëve e nga të cilët përbëhet Njësia Zgjedhore;
- 2.3. Numrin e anëtarëve të cilët i zgjedh njësia zgjedhore për Kuvendin e OFK-së.

3. Se në cilën Njësi Zgjedhore anëtar i Odës mund të kandidojë apo të votojë përcaktohet në bazë të Vendbanimit të përhershëm të anëtarit të Odës apo adresës së veprimtarisë së tij, të dëshmuara me Dokumentacionin përkatës të përfshira në databazën e OFK-së.

Komisioni i Njësisë Zgjedhore (KNJZ)

Neni 19

1. Në çdo Njësi Zgjedhore themelohet Komisioni i Njësisë Zgjedhore.
2. Komisioni i Njësisë Zgjedhore ka tre (3) anëtarë të cilët janë përgjegjës për administrimin dhe organizimin e zgjedhjeve brenda njësisë zgjedhore rajonale.
3. Komisionet përcaktohen nga KQZ për ushtrimin e këtyre funksioneve:
 - 3.1. Kryesues i KNJZ-së, Komisioner për fletëvotim dhe Komisioner i listës identifikuese.
4. KNJZ-të certifikohen me vendim të KQZ-së jo më vonë se pesë (5) ditë para ditës së zgjedhjeve. Propozimet për emërim të anëtarëve vijnë nga radhët e KQZ-së, të cilët mund të shpallin edhe publikisht thirrjen për aplikim për anëtarë të njësisë zgjedhore. Në rast se aplikojnë më shumë se 3 kandidatë, KQZ merr paraysh moshën më të re të anëtarit.
5. KNJZ-të do të kenë mandat deri në certifikimin e rezultatit zgjedhor nga KQZ-ja.
6. Anëtarët e KNJZ-së janë anëtarë me të drejtë vote në atë njësi. Vetëm në raste të jashtëzakonshme, si refuzimi i marrjes së detyrës nga të gjithë anëtarët apo mospërgjegjia për pranim të detyrës brenda 5 ditëve nga KQZ, KQZ mund të emërojë anëtarë të KNJZ-së edhe anëtar të cilët nuk janë votues të asaj njësie zgjedhore.
7. Anëtar i KNJZ-së nuk mund të caktohet të shërbejë ose të vazhdojë të shërbejë pasi që është caktuar, po që se ai/ajo është kandidat për anëtar të Kuvendit të OFK-së;
8. Anëtar i KNJZ-së nuk mund të caktohet të shërbejë si anëtar i KNJZ-së, nëse është në konflikt interesi lidhje familjare me ndonjë nga kandidatët e njësisë zgjedhore ku është caktuar anëtarë të cilin detyrohet ta deklarojë para se të ushtrojë funksionin në KNJZ.
9. Anëtar i KNJZ-së nuk mund të caktohet të shërbejë ose të vazhdojë të shërbejë, nëse ka dhënë nënshkrim mbështetës për ndonjërin prej kandidatëve për anëtar Kuvendi nga ajo Njësi Zgjedhore.
10. KQZ mund të nxjerr akt të veçantë me të cilin mund të përcaktojë kompetenca dhe përgjegjësi shtesë për KNJZ-së.
11. Emërimi i një anëtarit të KNJZ-së i nënshtrohet betimit dhe nënshkrimit të Kodit të Sjelljes së KQZ-së të miratuar nga KQZ-ja, para fillimit të punës.

Neni 20
Kompetencat dhe përgjegjësitë e KNJZ-së

1. KNJZ-të kanë kompetencë dhe përgjegjësi për:
 - 1.1. mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në vendvotimin e njësive zgjedhore;
 - 1.2. zbatimin e të gjitha masave të përcaktuara nga KQZ-ja për ta menaxhuar procesin e votimit;
 - 1.3. kujdesin ndaj materialit zgjedhor dhe përdorimin e tij sipas rregullave të përcaktuara nga KQZ-ja;
 - 1.4. shmangien dhe raportimin e parregullësive zgjedhore në rast të evidentimit të tyre;
 - 1.5. ndihmojë marrëveshjet teknike në Vendvotime dhe çdo përgatitje tjetër teknike për zgjedhje përfshirë pranimin e të gjithë materialit zgjedhor, kujdesin për të dhe dorëzimin e tij ditën e përfundimit të procesit zgjedhor në KQZ sigurojë mbajtjen e përshtatshme të votimit dhe të numërimit dhe përmbledhjen e rezultateve të zgjedhjeve brenda juridiksionit të tyre;
 - 1.6. kryerjen e punëve të tjera të përcaktuara nga KQZ-ja.
2. KQZ-ja mund ta revokojë në çdo kohë emërimin e secilit anëtar të KNJZ-së nëse anëtari:
 - 2.1. nuk i kryen detyrat e tij/saj sipas rregullave të KQZ-së;
 - 2.2. vepron në mënyrë të anshme dhe joprofesionale;
 - 2.3. nuk merr pjesë në dy takime të njëpasnjëshme të KNJZ-së apo KQZ-së pa ndonjë arsye të bazuar;
 - 2.4. merr pjesë në përkrahje të kandidatëve për anëtarë të Kuvendit.

Neni 21
Lokacionet e Vendvotimeve

1. Mbështetur në rekomandimet e Komisionit Njësive të Zgjedhjeve (KNJZ), KQZ-ja, përmes Sekretariatit të KQZ-së, jo më vonë se 5 ditë para zgjedhjeve, miraton adresën e vendvotimit për njësi zgjedhore dhe i publikon lokacionet e sakta të të gjitha vendvotimeve.
2. Secilit anëtar të regjistruar i caktohet vendvotimi që është lokacioni ku emri i tij/saj shfaqet në Listën Përfundimtare të Votuesve të përdorur gjatë mbajtjes së votimit në ditën e zgjedhjeve.
3. Nëse lokacioni i Venvotimi është ndryshuar pas përcaktimit të tij, KQZ i njofton votuesit për ndryshimin përmes formeve elektronike.

Neni 22

Plani i veprimit dhe buxheti

1. Plani i Veprimit është akt i miratuar i KQZ-së me të cilin bëhet konkretizimi i veprimeve dhe aktiviteteve të KQZ dhe KNJZ.
2. Plani i Veprimit do të përmbajë:
 - 2.1. Procesin e shpalljes së zgjedhjeve, njoftimin dhe publikimin si dhe, përcaktimin e metodologjisë së informimit;
 - 2.2. Veprimet që duhet ndërmarrë për sigurimin e Listës së Votuesve dhe veprimet në lidhje me verifikimin e saj;
 - 2.3. Oraret për sigurimin e materialit të nevojshëm për veprimet përgatitore të procesit zgjedhor;
 - 2.4. Caktimin e kohës dhe afateve për caktimin e anëtarëve të KNJZ-ve dhe procedimit për certifikim nga KQZ-ja;
 - 2.5. Mënyrën dhe veprimet e nevojshme për sigurimin e materialit zgjedhor;
 - 2.6. Të gjitha çështjet operationale mbi përgatitjen, menaxhimin dhe përfundimin e procesit zgjedhor.

3. Plani i Veprimit i miratuar nga KQZ-ja mund të ndryshohet apo të plotësohet nga KQZ-ja sipas nevojave që paraqiten gjatë zhvillimit të procesit zgjedhor.

Neni 23

Mjetet financiare për organizimin e zgjedhjeve

1. OFK siguron mjetet e nevojshme për organizimin e zgjedhjeve, të destinuara për:
 - 1.1. Sigurimin e materialit zgjedhor dhe materialeve tjera shpenzuese;
 - 1.2. Pajisjet dhe mjetet e nevojshme teknike për organizimin e zgjedhjeve;
 - 1.3. Shpenzimet e rrugës, post-telekomunikacionit, etj;
 - 1.4. Kompensimi për anëtarët e KQZ-së;
 - 1.5. Kompensimin e Sekretariatit;
 - 1.6. Kompensimi për anëtarët e KNJZ-së;
 - 1.7. Shpenzimet e informimit publik;
 - 1.8. Angazhim të personave tjerë për nevojat e procesit zgjedhor.
 - 1.9. Shpenzime të paparapara për organizimin e zgjedhjeve të miratuara nga KQZ.
2. Kompensimi i anëtarëve të KQZ-së, KNJZ-së dhe Sekretariatit përcaktohet nga Këshilli Drejtues në propozim të Kryetari të KQZ-së për periudhën 3 mujore të procesit të rregullt zgjedhor.
3. Kompensimi për procese të jashtëzakonshme jashtë afatit të rregullt zgjedhore vendoset me vendim të Këshillit Drejtues.

KREU IV LISTA VOTUESE

Neni 24

Përmbajtja e listës

1. KQZ-ja mban Listën e Votuesve dhe siguron që Lista e Votuesve është e saktë dhe e azhuruar, dhe e njëjta përmban ekstraktin më të vonë në dispozicion i të gjithë anëtarëve të regjistruar si anëtarë të OFK-së, e përpiluar mbi anëtarësimet deri në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve.
2. Pas certifikimit të listës përfundimtare anëtarët e rinjë të cilat sapo kanë përfunduar provimin e licencimit me rastin e regjistrimit deklarohen nëse do të vendosen në list ku kanë vendbanimin apo ku ushtrojnë veprimtarinë.
3. Lista e Votuesve përmban informatat si: emri, mbiemri, numri i anëtarësisë, numri licencës, numri personal, njësia zgjedhore, regjioni i caktuar për të votuar.
4. Për konfirmimin e të drejtës për votim, KQZ-ja ka qasje në regjistrat e anëtarëve përmes Shërbimit Profesional të OFK-së Shërbimi Profesional pajis KQZ-në me të gjitha informatat përkatëse që KQZ kërkon për të mirëmbajtur Listën e Votuesve në pajtim me afatet kohore të caktuara nga KQZ-ja.
5. KQZ-ja u ofron KNJZ-ve një kopje të shtypur të listës së votuesve për njësinë e tyre zgjedhore.

Neni 25

Kriteri i hartimit të listës votuese

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bën publikimin përfundimtar të listës së votuesve në njësitë përkatëse zgjedhore të cilat krijohen brenda regjioneve jo më vonë se 60 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.
2. Lista e votuesve në njësitë zgjedhore caktohet sipas kriterëve të vendbanimit të tyre ose kontratës/dokumentit të ushtrimit të veprimtarisë
- 3.

Neni 26

Shqyrtimi i Listës së Votuesve dhe Periudha e Kundërshtimit

1. Anëtarët e përfshirë në listën preliminare mund të kundërshtojnë, pasaktësitë apo lëshimet në Listën e Votuesve gjatë periudhës së vendosur për atë qëllim nga KQZ-ja.
2. Para fillimit të Periudhës së Kundërshtimit dhe Konfirmimit, Sekretariati i KQZ-së e bën LV-në të disponueshme në ëeb faqen e OFK-së dhe zyret e OFK-së.
3. Vendimet për ndryshimet në LV merren nga KQZ, pasi që anëtarët të ketë pasur mundësinë të sfidojë pasaktësitë dhe mangësitë në Listën e Votuesve. Mirëpo së paku 60 ditë para datës së zgjedhjeve, KQZ-ja vërteton se Lista e Votuesve është në përputhje me rregulloren dhe legjislacionin në fuqi duke certifikuar përfundimisht.
4. Njësi zgjedhore e anëtarit mund të ndryshohet vetëm nën arsyen se është i punësuar në institucion privat shëndetësor apo ka vendbanim tjetër i cili është në njësi tjetër zgjedhore nga ai i publikuar. Arsyetja të dëshmuar me dokumentacion përkatës (kontrata punes, certifikata vendbanimi)

Neni 27

Procedura e kundërshtimit dhe verifikimit

1. Çdo anëtar mund të paraqesë kërkesë për rishqyrtim të listës të votueseve duke parashtruar kërkesën e arsyetuar pranë KQZ-së së bashku me dokumentacionin përkatës
2. Anëtari që dëshiron të kundërshtojë një emër që mendon se nuk duhet të jetë në LV duhet të dorëzojë ankesë në KQZ duke theksuar qartë faktet që mbështesin kundërshtimin, duke përfshirë provat tjera relevante.
3. Anëtari mund të ngritë ankesë në KQZ nëse zbulon që emri i tij/saj nuk gjendet në LV. Një ankesë e tillë përfshinë çfarëdo prove relevante.
4. Afati mbi kundërshtimin vendoset nga KQZ, dhe duhet të publikohet së bashku me listën preliminare

Neni 28

Procesi i Vendosjes për kundërshtimet

1. KQZ njofton palë tjetër ndaj së cilës është ngritur ankesa, dhe u ofron këtyre palëve mundësinë për t'u përgjigjur.
2. KQZ pas mbylljes së afatit për kërkesat për rishqyrtim u komunikon vendimet lidhur me kërkesat palëve të cilat kanë paraqitur kundërshtimet dhe çfarëdo palë tjetër të cilës i është lëshuar njoftimi në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni.
3. Vendimi i KQZ-së për zgjidhjen e kundërshtimit mund ta atakohet në gjyqin e nderit.
4. Gjykata e Nderit të OFK-së është organ përfundimtar në shkallë të dytë i cili vendos për paraqitje të ankesës ndaj vendimit të KQZ-së.
5. Gjyqi i nderit ka autoritetin për të urdhëruar KQZ-në për të marrë masa riparuese për çështje në lidhje me kërkesat që kanë të bëjnë me LV-të.
6. Afatet procedurale për realizimin e të drejtave nga ky nen përcaktohen nga KQZ.

Neni 29

Certifikimi përfundimtar i listës së votuesve

1. KQZ pas mbarimit të afateve për atakim, dhe vendosjes nga organet kompetente në rast të ankesave KQZ certifikon listën përfundimtare të votuesve.
2. Certifikimi përfundimtar i listës së votuesve bëhet jo më vonë se 60 ditë para datës së mbajtjes së zgjedhjeve.
3. Anëtarët e rinjë të cilët regjistrohen në OFK, pas certifikimit të listës përfundimtare nuk ndikojnë në përcaktimin e vendeve në Kuvend për atë njësi zgjedhore.

KREU V
PËRFAQËSIMI, KANDIDIMI DHE ZGJEDHJET PËR KUVEND

Neni 30
Përfaqësimi në Kuvendin e Odës

1. Kuvendi i Odës ka 59 anëtarë të cilët zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë në regjionet e njësive zgjedhore të përcaktuara me Statutin e OFK-së sipas ndarjes administrative të regjioneve .
2. Anëtarët e Kuvendit zgjidhen sipas kriterit përfaqësues, një anëtar i Kuvendit për çdo (nr anëtarëve të përgjithshëm të regjistruar/ 59) anëtarë të regjistruar.
3. Secili nga regjionet funksionon si një njësi e vetme zgjedhore në regjion (01. Prishtinë, 02.Mitrovicë, 03.Pejë, 04.Prizren, 05.Ferizaj, 06 Gjilan dhe 07. Gjakovë) sipas ndarjes administrative.
4. Numri i Mandateve të Regjionit është i barabartë me herësin e prodhimit të Numrit të Farmacistëve të Regjionit dhe Numrit të Anëtarëve të Kuvendit të Odës duke pjesëtuar me Numrin e Farmacistëve të Republikës së Kosovës. "MandatetRegjion = (FarmacistëtRegjion x FarmacistëtKuvend) / FarmacistëtRKS". Për t'u arrite numri 59, plotësohet nga numrat pas presjes dhjetore duke u nise nga me i madhi tek me i vogli.
5. Mandati i anëtarëve të Kuvendit dhe anëtarëve të organeve të Odës është 4 vite dhe vazhdon deri në rizgjedhjen dhe konstituimin e Kuvendit të ri të OFK-së.
6. Nëse zgjedhjet për anëtarë të Kuvendit ose për organet e tjera të Odës nuk mbahen në kohën e duhur, anëtarët e zgjedhur (ekzistues), përkatësisht anëtarët e organeve të Odës, vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj, maksimumi një vit nga përfundimi i mandatit të tyre.

Neni 31
Procedura për kandidim

1. Çdo anëtar i Odës gëzon të drejtën që të kandidojë dhe të zgjedhet anëtar i Kuvendit të Odës në përputhje me Statutin dhe këtë rregullore, me përjashtim të anëtarëve të cilët :
 - 1.1. Janë të dënuar me vendim të formës së prerë me tërheqje të përkohshme të licensës prej të paktën 3 viteve, gjatë 5 viteve të fundit.
 - 1.2. Janë të dënuar me aktgjykim të formës së prerë (per shkelje) të detyrës zyrtare dhe(dhe rrezikim) shëndetit publik
 - 1.3. Anëtarët e KQZ-së dhe anëtarët e KNJZ-së
2. Kandidatura për anëtarë të Kuvendit të OFK-së duhet të mbështetet me nënshkrim nga së paku 5 anëtarë të OFK-së brenda njësisë përkatëse zgjedhore të kandidatit.
3. Mbledhja e nënshkrimeve bëhet në formularin e përcaktuar nga KQZ-ja.
4. Një anëtar i OFK-së mund të mbështes vetëm një kandidat për anëtar të Kuvendit të Odës.
5. Kandidati për anëtarë të Kuvendit nuk mund të jep nënshkrim mbështetës për kandidaturën e tij.
6. Afati dhe procedura për paraqitjen e kandidatutës pëcaktohet nga KQZ.

Neni 32
Certifikimi i listës së kandidatëve

1. KQZ është autoritet kompetentë që vendos nëse aplikuesi ka përmbushur kriteret e parapara me Statut, këtë rregullore dhe afatet procedural të përcaktuara nga KQZ. Pas përfundimit të procedurës së kandidimit, KQZ publikon listen preliminare.

2. Listën përfundimtare të kandidatëve sipas njësive zgjedhore. KQZ i certifikon dhe i publikon jo më larg se 10 ditësh nga dita që ka përfunduar afati për dorëzimin e kandidaturave.
3. Nga dita e publikimit të listës së kandidatëve preliminar, palët e pakënaqura lidhur me listën e Certifikuar të kandidatëve për Kuvendin e OFK-së, mund të paraqesin kërkesën për rishqyrtimin e saj në afat prej 48 orëve nga ora e publikimit dhe njoftimit në email. Kërkesa parashtrohet pranë KQZ, i cili e shqyrton kërkesën brenda 72 orëve nga ora që është pranuar kërkesa.
4. Ndaj vendimit të KQZ-së me të cilën është trajtuar kërkesa për rishqyrtim të vendimit, aplikuesi ka të drejtën e ankesës në shkallë të dytë në Gjyqin e Nderit.
5. Pas kalimit të afatit të ankesave dhe afateve të shqyrtimit të ankesave në rast të paraqitjes, KQZ-ja Certifikon listën përfundimtare të kandidatëve pjesëmarrës në zgjedhjet për anëtarë të Kuvendi të OFK-së.

KREU VI PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT ZGJEDHOR DHE DËRGIMI I MATERIALEVE ZGJEDHORE

Neni 33 Kriteri radhitjes në Listës së Votuesve

1. Lista e Votuesve paraqet evidencë të anëtarëve të OFK-së me të drejtë vote përpilohet sipas rendit alfabetik të emrave të tyre
2. Të dhënat nga paragrafi paraprak këtij neni do të përpunohen dhe të menaxhohen në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 34 Fletëvotimet

1. KQZ-ja përcakton numrin e fletëvotimeve të cilat shtypen dhe shpërndahen.
2. Fletëvotimi është me ngjyrë dhe formë të njëjtë për të gjitha njësitë zgjedhore.
3. Sasia e fletëve të votimit është deri në 2% më e madhe se numri i anëtarëve në atë njësi zgjedhore.
4. Fletët e votimit për zgjedhjet përgatiten nga KQZ-ja dhe duhet të përmbajnë elemente sigurie sipas përcaktimeve me akt normativ të KQZ-së.
5. Fletë votimet shtypen nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejt të KQZ-së apo Sekretariatit të KQZ-së.
6. Fletë votimi duhet të përmbajë:

6.1. treguesin e njësisë zgjedhore;

6.2. organin që do të zgjidhet;

6.3. numrin rendor, dhe emrin e mbiemrin e kandidatëve të renditur sipas rendit alfabetik të emrave të tyre.

7. KQZ-ja më tutje përcakton me anë të rregullës detajet e fletë votimeve:

7.1. përmbajtjen;

7.2. formatin dhe ekspozimin/dukjen;

7.3. mënyrën dhe kontrollin e printimit;

7.4. verifikimin, shpërndarjen dhe trajtimin e fletëve të votimit;

7.5. veçoritë e sigurisë;

7.6. çfarëdo çështje tjera të lidhura që nuk mbulohen me këtë rregullore.

7.7. Pjesën e fletvotimit i cili vulloset

Neni 35
Distribrimi dhe përdorimi i Listës së Votuesve

1. Pas certifikimit të Listës së Votuesve, KQZ-ja do të sigurojë për secilën KNJZ Listën e Votuesve për Njësinë përkatëse Zgjedhore.
2. KNJZ-të do të disponojnë vetëm pjesën e Listës së Votuesve në të cilën përfshihen anëtarët me të drejtën e votës në njësinë përkatëse zgjedhore.
3. Listat e Votuesve për secilën Njësi Zgjedhore do t'i distribuohen KNJZ-ve përmes Sekretariatit të KQZ-së. Sekretariati i KQZ-së është i obliguar që Listat e Votuesve për Njësitë Zgjedhore t'ua dërgojë në afat jo më të largët sesa njëzet e katër (24) orë para hapjes së vendvotimit.
4. Nga momenti i dorëzimit të Listës së Votuesve për Njësinë Zgjedhore përkatëse, përgjegjësia për ruajtjen e saj është e kryesuesit të KNJZ-së.

Neni 36
Trajnimi dhe shpërndarja e materialit zgjedhor

1. KQZ organizon trajnim për anëtarët e KNJZ-ve në lidhje me rregullat zgjedhore dhe organizimin e oricesit zgjedhore
2. Trajnimi mbahet së paku 24 orë para ditës së zgjedhjeve. Ditën e trajnimit dorëzohen edhe materialet zgjedhore në KNJZ
3. Me rastin e dorëzimit nga Kryesuesi i KQZ-së dhe kryesuesi KNJZ-së apo personave të autorizuar nga ta nënshkruhet procesverbal i cili përmban të dhënat e materialeve të dorëzuara si :
 - 3.1. Lista e votuese
 - 3.2. Numrin e fletëvotimeve të dorëzuara
 - 3.3. Libri i votimit
 - 3.4. Kutinë e votimit
 - 3.5. Materialet tjera si Flika, FPR etj
 - 3.6. Materiale shpezues si kimik. Ngjitës etj
 - 3.7. Materiale tjera të përcaktuara nga KQZ
 - 3.8. Një kopje të procesverbalit merr edhe KNJZ-ja përkatëse

KREU VI
MENAXHIMI I VENDVOTIMEVE GJATË PROCESIT ZGJEDHOR

Neni 37
Përgatitja e vendvotimit

1. KQZ-ja vendos një rregull e cila qeverisë rregullat e procedurës, shpërndarjet dhe pranimin e materialeve për zgjedhje të cilat i dërgohen KNJZ-së.
2. Në Ditën e Zgjedhjeve, Kryesuesi i KNJZ-së, i dërgoj materialet për mbajtjen e zgjedhjeve në vendvotim
3. Të gjithë anëtarët e KNJZ-së duhet të jenë të pranishëm në vendvotim së paku njëorë para fillimit të votimit.
4. Komisionerët e KNJZ-ve janë përgjegjës për përgatitjen teknike të vendvotimeve nëpër Njësitë Zgjedhore.
5. Komisionerët do të rregullojnë në atë mënyrë vendvotimin ashtu që do të rendisin tavolinën në

- ballë të hyrjes së vendvotimit ku do të qëndrojë komisioneri për Listë të Votuesve, ndërkaj kutia e votimit do të vendoset në mesin e hapësirës së vendvotimit.
6. Komisionerët janë të obliguar që të përgatisin vendin e veçantë ku votuesi do të votojë në mënyrë që të ruhet fshehtësia e votës së tij. Tavolina e votimit duhet të vendoset në atë mënyrë që votuesi ta ketë shpinën e kthyer nga komisionerët dhe vëzhguesit e pranishëm. KNJZ-te mund të caktojnë më tepër se një tavolinë të votimit, por jo më tepër se tri (3) tavolina për vendvotim.
 7. Rregullimi teknik dhe fizik në vendvotim nuk do të ndryshohet pa leje të KQZ-së deri në përfundimin e procesit të votimit, respektivisht deri në mbylljen e tij.

Neni 38

Hapja dhe mbyllja e vendvotimit

1. KNJZ-te janë të obliguara që të hapin vendvotimet në orën 09:00 të ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve, sipas vendimit të KQZ-së për shpalljen e zgjedhjeve për Kuvendin e OFK-së.
2. Nëse vendvotimi hapet me vonesë, Kryesuesi i KNJZ-së e informon menjëherë informon Sekretariatit e KQZ-së dhe regjistron kohën e hapjes në Librin e vendvotimit.
3. Vendvotimet e hapura sipas paragrafit 1 të këtij neni do të mbyllen në orën (19:00) të së njejtës dite kur mbahet votimi. Pas mbylljes së vendvotimit askush nuk do të lejohet të votojë. Vendvotimi do të konsiderohet i mbyllur me votimin e votuesit të fundit i cili është i pranishëm pranë vendvotimit në orën (19:00).
4. KNJZ-te mund të mbyllin vendvotimin para kohës së përcaktuar me paragrafin 3 të këtij neni po që se kanë votuar të gjithë anëtarët me të drejtë vote nga Lista e Votuesve.
5. Komisionerët duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së mbajtjes së procesit zgjedhor, ku të paktën duhen të jenë të pranishëm dy nga tre komisionerë të KNJZ-ve kur për lëshimin e vendvotimit është natyra e nevojave personale. Mungesa e cilitdo nga komisionerët nuk mund të jetë në kohëzgjatje më tepër se tridhjetë (30) minuta.
6. Anëtarët e KNJZ-ve dhe Kryesuesi votojnë të parët kur hapet vendvotimi.

Neni 39

Mbyllja e votimit

1. Çdo anëtar në rresht në orën e mbylljes së Vendvotimit, lejohet të votojë nëse ka të drejtë për të votuar. Kontrolluesi i rreshtit e informon personin e fundit në rresht se ai/ajo është personi i fundit që voton. Çdo person tjetër që i bashkohet rreshtit pas atij personi, nuk lejohet të hyjë në Vendvotim, dhe informohet për pamundësinë e tij/saj për të votuar.
2. Pasi të votojë personi i fundit në rresht në kohën e përfundimit të votimit, kryesuesi i KNJZ-së e mbyll Vendvotimin, e mbyll kutinë e votimit në atë mënyrë që kjo të mund të shikohet nga vëzhguesit e pranishëm, dhe në librin e votimit e shënon kohën e saktë të mbylljes.

KREU VIII

MENAXHIMI I PROCESIT TË VOTIMIT

Neni 40

Procesi i votimit

1. Votimi është personal dhe bëhet në fletëvotim, duke shenjëzuar emrin e kandidatit që zgjedhen në Kuvendin e Odës.
2. Votuesi ka të drejtë të votojë vetëm për një (1) kandidat.
3. Votuesi me të hyr në vendvotim është i obliguar që ta dëshmojë identitetin e tij për identifikimin e të drejtës së tij në votë në Listën e Votuesve me dokumentet në vijim:

- 3.1. letërnjoftimi i vlefshëm;
- 3.2. ID – Kartela e OFK-së;
- 3.3. pasaporta valide;
- 3.4. leja e vozitjes e vlefshëm.

4. Komisioneri i Listës së votuesit pasi që ta ketë vërtetuar identitetin e votuesit dhe ka gjetur emrin e tij në Listën e Votuesit, duhet që të kërkojë nga votuesi që të nënshkruhet në rubrikën e Listës së Votuesve në hapësirën e dedikuar për nënshkrim për votuesin e identifikuar në Listën e Votuesve.
5. Pas nënshkrimit në Listën e Votuesve, komisioneri kontrollor do t'i dorëzojë fletë votimin e palosur dyfish, duke u përmbajtur nga çlido udhëzim për të favorizuar për votim cilindo nga kandidatët. Komisioneri kontrollor mund të njoftojë votuesin vetëm për rregullsinë e mënyrës së votimit që i përket të drejtës që në fletëvotim votuesi të shënojë vetën njërin nga kandidatët e listuar në fletëvotim.
6. Votuesi pasi që ta pranojë fletëvotimin do të drejtohet në tavolinën e votimit e cila është vendosur në pajtim dispozitën e kësaj rregullore. Pasi që votuesi ta ketë përfunduar votimin, fletëvotimin e tij ai duhet ta fus në kutinë e votimit. Komisioneri kontrollor është i obliguar që të verifikojë futjen e fletëvotimit në mënyrë që në fletëvotimin e paluar të shihet vula zyrtare e KQZ së.

Neni 41 **Sanksionimi penal**

Votimi në zgjedhjet e njëjta më shumë se një herë përbën veprë penale dhe është i dënueshëm në përputhje me kodin e etikës nga kjo rregullore si dhe Kodin Penal të Kosovës.

Neni 42 **Rendi dhe rregulli në vendvotim**

1. Kryesuesi i vendvotimit do të kujdeset që në vendvotim të sigurohet rendi dhe rregulli në kuptim të respektimit të procedurave dhe përmbajtjes të pjesëmarrësve në proces zgjedhor nga veprimet e ndaluara me rregullimin e përcaktuar nga KQZ-ja.
2. Kryesuesi është i obliguar që mos të lejon hyrjen dhe qëndrimin e personave në vendvotim, përfshirë edhe votuesit pasi ta kenë përfunduar votimin. Votuesit do të futen në vendvotim deri në atë numër sa nuk cënohet rendi në vendvotim.
3. Komisionerët, vëzhguesit dhe cilido nga votuesit e pranishëm nuk lejohet që të ndikojnë në çfarëdo mënyre tek votuesit për të votuar ndonjërin nga kandidatët.
4. Në rast se ndonjëri nga të pranishmit nuk respekton rregullin nga paragrafi 3 i këtij neni, kryesuesi i vendvotimit ka të drejtë që t'ia tërheqë vërejtjen. Në rast se veprimi i tillë përsëritet nga personi i njëjtë kryesuesi ka të drejtë që të kërkojë largimin e tij nga vendvotimi. Kryesuesi është i obliguar që në çdo rast kur refuzon personi i tillë që të veprojë sipas kërkesave të tij, të lajmërojë organet e rendit.
5. Kur veprimet nga paragrafi 4 i këtij neni ndërmerren nga ndonjëri nga komisionerët, kryesuesi do të veprojë në të njëjtën mënyrë sikurse në paragrafin e cituar. Në rast të largimit nga vendvotimi të komisionerit, procesi i votimit do të vazhdojë. Procesi i v o t i m i t do të ndalohet në rast se në vendvotim nga tre (3) komisionerë mbetet vetëm kryesuesi, atëherë ai do të kontaktojë me Sekretariatit e KQZ-së dhe me vendim të KQZ-se do të autorizohet një person që të përmbush kushtin minimal të pranisë prej së paku dy komisionerëve, përfshirë kryesuesin e vendvotimit.
6. Në çdo rast kur vije deri te cënimi i rendit dhe rregullit në vendvotim, vërejtjet e tilla dhe veprimet sipas këtij neni do të shënohen në Librin e Votimit.
7. Prishja e rendit, qetësisë dhe pengesat e bëra gjatë procesit zgjedhorë konsiderohen shkelje të rënda të etikë profesionale.

Neni 43
Libri i Votimit

1. Libri i Votimit është formë e përcaktuar nga KQZ-ja në të cilën shënohen vërejtjet dhe ngjarjet e rëndësishme që ndërlidhen me procesin zgjedhor në vendvotimin përkatës gjatë ditës së zgjedhjeve.
2. Libri i Votimit mirëmbahet dhe ruhet ekskluzivisht nga kryesuesi i vendvotimit.
3. Në Librin e Votimit të drejtën për të shënuar vërejtjet kanë komisionerët dhe vëzhguesit e akredituar.
4. Në çdo rast kur votuesi paraqet vërejtjet lidhur me procesin e votimit, kryesuesi është i obliguar që ta shënojë deklaratën e tij dhe pasi që t'ia lexojë deklaratën e shënuar e nënshkruan së bashku me votuesin i cili ka paraqitur vërejtjen.
5. Libri i Votimit është material zgjedhor dhe si i tillë duhet të dorëzohet në KQZ së bashku me materialin tjetër përcjellës zgjedhor.

KREU IX
PROCESI I NUMËRIMIT TË VOTAVE

Neni 44
Numërimi i votave

1. Pas mbylljes së vendvotimit, kryesuesi i vendvotimit do t'i tërheqë vërejtjen vëzhguesve që mos ta lëshojnë vendvotimin deri në përfundimin e procesit të numërimit të votave. Në rast se ndonjëri nga ta e lëshon vendvotimin, kryesuesi i njofton se nuk do të lejojë hyrjen e sërishme të tyre në vendvotim.
2. Procesi i numërimit fillon me numërimin e votuesve të nënshkruar në Listën e Votuesve dhe numrin e tillë e evidentojnë për shënim në procesverbal.
3. Më pas numërohen fletëvotimet e papërdorura dhe poashtu ky numër evidentohet dhe shënohet në procesverbal.
4. Me hapjen e kutisë së votimit fillon diferencimi i fletëvotimeve të dëmtuara duke shënuar numrin e tyre.
5. Pas diferencimit të fletëvotimeve të dëmtuara, procesi i numërimit fillon me identifikimin e fletëvotimeve të pavlefshme që konsiderohen kur:
 - 5.1. në fletëvotim janë shënuar më tepër se një kandidat;
 - 5.2. kur nuk është i qartë votimi i votuesit;
 - 5.3. kur në fletëvotim janë shënuar përmbajtjet në përjashtim të shenimit të kandidatit i cili është shënuar;
6. Pas diferencimit të votave të pavlefshme, fillon numërimi një nga një votë duke mbajtur evidencën për secilën votë të numëruar.
7. Numërimi do të bëhet në atë mënyrë ku njëri nga komisionierët do të caktohet nga kryesuesi për tregimin e secilit fletëvotim duke e ngritur atë në pozitë të dukshme për të gjithë të pranishmit. Kryesuesi dhe komisioneri tjetër do të mbajnë paralelisht evidencat që në fund të bëhet krahasimi i saktësisë së numërimit.
8. Pas përfundimit të numërimit dhe krahasimit të dhënave të mbajtura nga kryesuesi dhe njëri nga komisionerët, rezultati i tillë shënohet në procesverbalin e vendvotimit dhe atë të KNJZ-së.
9. Nëse evidenca e mbajtur nga kryesuesi dhe njëri komisioner nuk përputhet, atëherë do të përsëritet numërimi deri në konstatimin e plotë të dyanshëm nga kryesuesi dhe komisioneri.

Neni 45
Përmbyllja e procesit të numërimit

1. Pas numërimit të votave dhe përmbylljes së procesverbalit të procesit të përgjithshëm (FPR) dhe procesverbalit për votat e kandidatëve (FRK) i cili nënshkruhet nga kryesuesi dhe komisionerët e KNJZ-së, fletëvotimet e vlefshme diferencohen nga fletëvotimet e dëmtuara dhe ato të pavlefshme. Fletëvotimet e dëmtuara dhe të pavlefshme futen në një thes të vepantë.
2. Kutia e votimit e mbyllur dorëzohet në Sekretariatit të KQZ-së nga ana e kryesuesit posa që të ketë përfunduar procesi i numërimit dhe ambalazhimit të materialit zgjedhor për dorëzim. Procesverbalet e votimit së bashku me materialet tjera përjashtimisht fletëvotimit, vendosen jashtë kutisë së votimit.
3. Kryesuesi i KNJZ-së, është përgjegjës për përmbledhjen dhe saktësinë e rezultateve të votimit të marra nga shënimet e vendvotimit të bëra në format e kërkuara dhe e dërgon formën e kompletuar të FPR-së në KQZ.
4. Rezultatet e numërimit në KQZ vendosen në vendvotim nga Kryesuesi i NJZ-së dhe kopja tjetër dërgohet në KQZ.
5. KQZ-ja pas pranimit të materialit zgjedhor nga Sekretariati i KQZ-së, do të fillojë procesin e verifikimit dhe përmbledhjes së rezultateve nga KNJZ-të.
6. Materiali zgjedhor duhet t'i dorëzohet Sekretariatit të KQZ-së jo më vonë se ora 00:00 e ditës së zgjedhjeve.

KREU X
CERTIFIKIMI DHE SHPALLJA E REZULTATIT ZGJEDHOR

Neni 46
Certifikimi dhe shpallja e rezultatit

1. Pasi të jenë mbledhur të dhënat nga procesverbalet e KNJZ-ve, KQZ-ja konfirmon kandidatët që kanë fituar më së shumti vota në kuadër të Njësisë Zgjedhore. Kandidatët që kanë marrë më së shumti vota sipas bazës së konstatuar delegeuse nga KQZ-ja konsiderohet se kanë fituar mandatin zgjedhor.
2. Në rast se dy apo më shumë kandidat kanë vota të barabarta për fitimin e mandatit, në prani të KQZ-se hedhet shorti sipas të cilit konstatohet fituesi i mandatit.
3. KQZ-ja pasi ta ketë përfunduar procesin e evidentimit të mandateve krijon listën unike të kandidatëve që kanë fituar mandatin. Kjo listë materializohet nga Sekretariati i KQZ-së dhe procedohet për certifikim në mbledhjen e thirrur nga kryesuesi i KQZ-së.
4. KQZ-ja e certifikon rezultatin zgjedhor jo më larg se pesë (5) ditë nga dita e zgjedhjeve.
5. Në afat prej 24 orëve para certifikimit të rezultatit zgjedhor, KQZ-ja publikon rezultatin preliminar në faqen zyrtare të OFK-së.

Neni 47
Ankimimi në procesin zgjedhor

1. Secili kandidat që ka marrë pjesë në procesin zgjedhor ka të drejtë të parashtojë ankesë lidhur me parregullësinë e procesit zgjedhor.
2. Palët e pakënpura me rezultatin e publikuar mund të paraqesin kundërshtimin e tyre pranë KQZ-së në afat prej 24 orëve nga mbyllja e votimit apo njoftimi/ publikimi i rezultatit preliminar.
3. KQZ-ja do të shqyrtojë kundërshtimin e tillë në brenda 48 orëve nga ora e pranimit të kundërshtimit. Parashtrimi i kundërshtimit e pezullon procesin e certifikimit të rezultatit përfundimtar deri në

nxjerrjen e vendimit përfundimtar të KQZ-së.

4. KQZ-ja do të vendosë për ankesat e parashtruara me vendim përmes të cilit:

4.1. Aprovon ankesën dhe ndërmerri hapa për përmirësimin e rezultatit sipas gjetjes së konstatuar.

4.2. aprovon ankesën si të bazuar dhe urdhëron rinumërimin e vendvotimit;

4.3. aprovon ankesën dhe urdhëron ri-votimin në vendvotimin e caktuar; dhe

4.4. hedhë poshtë ankesën si të pabazuar apo të palejuar.

5. Pala e pakënaqur me vendimin e KQZ-së ka të drejtë ankesë në afat prej 48 orësh prej njoftimit të vendimit, në Gjyqin e Nderit si organ i shkallës së dytë i cili vendosë brenda 48 orësh nga pranimi i ankesës.
6. Gjyqi i nderit në procesin e ankesës mund të vendosë përshtatshmërisht me veprimet e KQZ-së nga ky nen.
7. Vendimi i Gjyqit të Nderit është përfundimtar.

Neni 48

Certifikimi i rezultateve përfundimtare për Kuvendin

1. Procesi zgjedhor për Kuvendin e OFK-së konsiderohet i përfunduar me shpalljen e rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja pasi të kenë përfunduar afatet e ankesës apo të jetë vendosur për këto ankesa.
2. KQZ-ja i publikon rezultatet e zgjedhjeve përfundimtare në ëeb faqe. Sekretariati i KQZ-së i publikon këto rezultate përfundimtare në formë tabelare duke përfshirë edhe publikimin në faqen e vetë të internetit:

2.1. numri i zgjedhësve të regjistruar;

2.2. numri i zgjedhësve të cilët kanë votuar në secilin njësi zgjedhore;

2.3. numri i zgjedhësve që kanë votuar (numri përfundimtar i votimeve të bëra);

2.4. numri i pranuar i fletëvotimeve të vlefshme;

2.5. numri i papërdorur i fletëvotimeve;

2.6. numri i fletëvotimeve të përdorura;

2.7. numri i fletëvotimeve të pavlefshme;

2.8. numri i fletëvotimeve të zbrazëta;

2.9. numri i fletëvotimeve të dëmtuara;

2.10. numri i votave për secilin kandidat;

2.11. emrat e kandidatëve të zgjedhur.

KREU XI

ZGJEDHJA E KRYETARIT DHE ZËVENDËS KRYETARIT TË OFK-SË

Neni 49

Kushtet dhe procedura e kandidimit

1. KQZ shpallë zgjedhjet për Kryetar të OFK, më së voni 5 (pesë) ditë pas ditës së certifikimit të rezultatit zgjedhor.
2. Dorëzimi i formularëve për kandidim së bashku me CV dhe programin (përvoja, vizioni dhe objektivat), dorëzohen në KQZ, për certifikim bëhet brenda 7 ditëve nga dita e shpalljes së zgjedhjeve.
3. Secila kandidaturë për Kryetar të OFK duhet të mbështetet me nënshkrimet e 10 anëtarëve të Kuvendit të OFK-së. Kandidati nuk mund të jap nënshkrim mbështetës për veten.
4. Çdo anëtarë i Kuvendit ka të drejtë të japë nënshkrimin vetëm për një kandidaturë.

5. Kandidati për kryetar të OFK-së nënshkruan deklaratën për konflikt interesi.
6. Kandidati për Kryetar duhet të plotësojë kushtet e parapara me Statutin e OFK-së :
 - 6.1. Të ketë së paku 5 vjet përvojë pune në fushën e farmacisë
 - 6.2. Të mos jetë i dënuar për shkelje të kodit etik dhe vepër penale
7. KQZ është organ kompetent për vlerësimin e përmbushjes së kritereve të Statutit të OFK-së dhe kësaj rregullore.
8. Plotësimi i kërkesave për kandidim për kryetar të përcaktuara nga Statuti i OFK-së dhe kjo rregullore dëshmohen me rastin e kandidimit përmes dokumenteve, procedurës dhe afateve të përcaktuara nga KQZ-ja.
9. Ndaj vendimit të KQZ mund të bëhet kërkesë për rishqyrtim të vendimit.
10. Vendimi KQZ ndaj kërkesës për rishqyrtim mund të atakohet në Gjyqin e Nderit.
11. Afatet procedurale nga ky nen, caktohen nga KQZ.

Procesi i votimi dhe zgjedhjes së kryetarit **Neni 50**

1. Kryetari i OFK-së zgjedhet kandidati i cili në roundin e parë të votimit merr gjysmën e votave të anëtarëve të përgjithshëm të Kuvendit.
2. Në rast se asnjëri nga kandidatët nuk arrinë numrin e mjaftueshëm për t'u zgjedhur në roundin e parë, zhvillohet roundi i dytë mes dy kandidatëve më të votuar në roundin e parë. Në raundin e dytë, Kryetar i OFK-së zgjedhet kandidati i cili ka marrë gjysmën e votave të anëtarëve të pranishëm të Kuvendit.
3. Nëse edhe pas roundi të dytë nuk zgjedhet Kryetari i OFK-së, përsëritja e votimit bëhet në afat prej jo më larg se 10 ditësh nga dështimi i roundit të dytë.
4. Nëse edhe pas përsëritjes së raundit të dytë asnjëri nga dy kandidatët nuk arrijnë të marrë gjysmën e votave të anëtarëve të pranishëm, Kuvendi i OFK-së shpërndahet dhe organizohen zgjedhjet e reja për Kuvend.
5. Zgjedhjet mbahen brenda 45 ditësh nga dita e dështimit të këtij roundi. Data e zgjedhjeve vendoset nga KQZ.
6. Me përfundimin e procesit zgjedhor, KQZ shpall rezultatin e zgjedhjes së Kryetarit të Odës dhe me këtë rast përpilon procesverbalin e veçantë në të cilin evidentohen hollësitë e procesit zgjedhor. Formën e procesverbalit të tillë e miraton KQZ-ja.
7. Mandati i kryetarit zgjat katër (4) vjet

Neni 51 **Zgjedhja e Zv.kryetarëve të OFK-së**

Me propozim të Kryetarit të OFK-së, Kuvendi me shumicë votash të anëtarëve prezent zgjedh zv.Kryetarët në një votim të hapur

KREU XII **KËSHILLI DREJTUES**

Neni 52 **Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues**

1. Jo më vonë se 30 ditë nga dita e zgjedhjes së Kryetarit të OFK-së bëhet zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues të OFK-së
2. Kryetari dhe dy zv.kryetarët e OFK-së janë anëtarë të Këshillit Drejtues sipas detyrës zyrtare.
3. Kandidatura për anëtarë të Këshillit Drejtues duhet të mbështet nga së paku 5 nënshkrime të anëtarëve

të Kuvendit

4. Një anëtar i kuvendit mund të mbështesë vetëm një kandidatë për Këshill Drejtues.
5. Votimi për anëtarë të Këshillit Drejtues është i drejtpërdrejt dhe i fshehtë.
6. Një anëtar i kuvendit të OFK-së mund të votojë vetëm një kandidatë për anëtarë të Këshillit Drejtues.
7. Kandidatura për Këshill Drejtues së bashku me nënshkrimet dorëzohet në KQZ.
8. Certifikimin e kandidaturave e bën KQZ.
9. Kandidatët që kanë fituar më shumë vota, zgjidhen anëtarë të Këshillit Drejtues.
10. Afatet dhe detajet tjera procedurale përcaktohen nga KQZ.

KREU XIII KËSHILLI MBIKQYRËS

Neni 53

Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës

1. Jo më vonë se 60 ditë nga zgjedhja e Kryetarit të OFK-së, bëhet zgjedhje e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës.
2. Këshilli mbikqyrës i OFK-së ka kryetarin, zv.kryetarin dhe 3 anëtarë të cilët zgjidhen nga Kuvendi i OFK-së me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.
3. Kandidatura për anëtarë, zv.kryetar dhe anëtarë të Këshillit Mbikqyrës duhet të mbështetet nga së paku 5 nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit të OFK-së.
4. Një anëtar i kuvendit mund të mbështesë vetëm një kandidatë për Këshill Mbikqyrës.
5. Kandidatura së bashku me nënshkrimet dorëzohen në KQZ.
6. Kandidatua është e ndarë në Kryetar, Zv. Kryetar dhe anëtarë.
7. Kandidatët që kanë fituar më shumë vota, zgjidhen në Këshilli Mbikqyrës.
8. Afatet dhe detajet tjera procedurale përcaktohen nga KQZ.

KREU XIV KËSHILLI ETIK

Neni 54

Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Etik

1. Jo më vonë se 60 ditë nga zgjedhja e Kryetarit të OFK-së, bëhet zgjedhje e anëtarëve të Këshillit Etik.
2. Këshilli Etik i OFK-së ka kryetarin, zv.kryetarin dhe 2 anëtarë të cilët zgjidhen nga Kuvendi i OFK-së me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.
3. Kandidatura për anëtarë, zv.kryetar dhe kryetar të Këshillit Etik duhet të mbështetet nga së paku 5 nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit të OFK-së.
4. Një anëtar i kuvendit mund të mbështesë vetëm një kandidatë për Këshill Etik.
5. Kandidatura së bashku me nënshkrimet dorëzohen në KQZ.
6. Kandidaturat janë të ndara në Kryetar, zv. Kryetarë dhe anëtarë.
7. Kandidatët që kanë fituar më shumë vota, zgjidhen në Këshillin Etik.
8. Afatet dhe detajet tjera procedurale përcaktohen nga KQZ.

KREU XV GJYQI I NDERIT

Neni 55

Zgjedhja e anëtarëve të Gjyqit të Nderit

1. Jo më vonë se 60 ditë nga zgjedhja e Kryetarit të OFK-së, bëhet zgjedhje e anëtarëve të Gjyqit të Nderit.

2. Gjyqi i nderit i OFK-së ka kryetarin, zv.kryetarin dhe 3 anëtarë të cilët zgjidhen nga Kuvendi i OFK-së me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.
3. Kandidatura për anëtarë, zv.kryetar dhe kryetar të Gjyqit të Nderit duhet të mbështetet nga së paku 5 nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit të OFK-së.
4. Një anëtar i kuvendit mund të mbështesë vetëm një kandidatë për Gjyq të Nderit.
5. Kandidatura së bashku me nënshkrimet dorëzohen në KQZ.
6. Kandidaturat janë të ndarë në Kryetar, zv. Kryetar dhe anëtarë.
7. Kandidatët që kanë fituar më shumë vota, zgjidhen në gjyqin e nderit.
8. Afatet dhe detajet tjera procedurale përcaktohen nga KQZ.

KREU XVI PROKURORI DHE ZV. PROKURORI

Neni 56 Zgjedhja e Prokurorit dhe zv. Prokurorit

1. Jo më vonë se 60 ditë nga zgjedhja e Kryetarit të OFK-së, bëhet zgjedhje e Prokurorit dhe zv. Prokurorit të OFK-së.
2. Kandidaturat për Prokurorë dhe zv.Prokurorë votohen me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë nga anëtarët e Kuvendit.
3. Kandidatura për Prokurorë dhe zv. Prokurorë të OFK-së duhet të mbështetet nga së paku 5 nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit të OFK-së.
4. Një anëtar i kuvendit mund të mbështesë vetëm një kandidatë për Prokurorë dhe zv. Prokurorë të OFK-së.
5. Kandidatura së bashku me nënshkrimet dorëzohen në KQZ.
6. Kandidatura është e ndarë në Prokurorë dhe zv. Prokurorë.
7. Kandidatët që kanë fituar më shumë vota, zgjidhen.
8. Afatet dhe detajet tjera procedurale përcaktohen nga KQZ.

KREU XVII KOMISIONET E PËRHERSHME TË ODËS

Neni 57 Zgjedhja e Komisioneve të Përhershme dhe të përkohëshme të Odës

1. Anëtarët e komisioneve të përhershme dhe të përkohëshme të Odës propozohen nga Këshilli Drejtues dhe propozimi i tillë aprovohet në Kuvendin e Odës me votim të hapur.
2. Propozimet nga paragrafi 1 i këtij neni konsiderohet se janë miratuar me shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit që kanë përmbushur kuorumin e përgjithshëm.

KREU XVIII PËRJASHTIMI I VOTËS SË FSHEHTË

Neni 58

Përfshirja e votës së fshehtë me rastin e zgjedhjes së organeve nga Kuvendi

Në të gjitha rastet kur numri i kandidatëve të certifikuar për zgjedhje në një pozitë në kuadër të organeve të OFK-së është i barabartë me numrin e pozitave të atij organi, votimi nga Kuvendi bëhet i hapur me përfshirje të Kryetarit të Odës.

KREU XIX

SHKARKIMI DHE PEZULLIMI I ANËTARËVE TË ORGANEVE TË ODËS

Neni 59

Zëvendësimi i anëtarëve të cilët përfundojnë mandatin para përfundimit të mandatit të rregullt të Kuvendit

1. Në rast se për cilëndo rrethanë të paraparë me dispozitat e Statutit apo rregulloreve në fuqi, anëtarit të Kuvendit i ka pushuar mandati para kohës së skadimit të mandatit të Kuvendit të OFK-së, zëvendësimi i të njëjtit do të bëhet nga KQZ-ja.
2. Zëvendësimi do të bëhet me njoftimin formal nga Kryetari i OFK-së si kryesues i Kuvendit të OFK-së.
3. Jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e njoftimit formal nga Kryetari i OFK-së, KQZ-ja do të bëjë zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit të cilit i ka pushuar para kohe mandati, duke e konstatuar zëvendësimin e tillë me kandidatin e të njëjtës njësi zgjedhore me numër të votave që është renditur pas anëtarit të cilit i ka pushuar mandati.
4. Mandati i anëtarit të ri të Kuvendit zgjat deri në skadimin e mandatit aktual të anëtarëve të zgjedhur në zgjedhjet e rregullta.
5. Në rastet kur në njësinë zgjedhore nuk ka kandidat i cili e pason me vota anëtarin e Kuvendit i cili duhet të zëvendësohet, KQZ-ja i shpallë zgjedhjet në atë njësi zgjedhore, dhe mund të përgjysmojë afatet e parapara me këtë rregullore sa i përket procedurave zgjedhore të parapara me këtë rregullore.
6. Të gjitha dispozitat e kësaj rregullore janë të zbatueshme përshtatshmërisht me rastin e zëvendësimit të anëtarit të Kuvendit lidhur me organizimin e procesit zgjedhor në mënyrë të veçantë në njësitë përkatëse zgjedhore.
7. Në rast të humbjes së mandatit të anëtarëve të organeve të OFK-së të cilat zgjedhen nga Kuvendi i OFK-së, për këto pozita hapen zgjedhje të reja.

Neni 60

Inicimi i kërkës për revokim të anëtarit të Kuvendit

1. Secili anëtarë nga njësinë zgjedhore e cila ka zgjedhur anëtarin e Kuvendit ka të drejtë të ndërmarrë iniciativën për Shkarkimin e anëtarëve të Kuvendit nga ajo njësi zgjedhore në përputhje me Statutin dhe këtë rregullore.
2. Kërkesa e anëtarëve për Shkarkimin e mandatit të anëtarësit nga Kuvendi i Odës, duhet të nënshruhet nga 1/3 e anëtarëve të njësisë përkatëse zgjedhore.
3. Mbledhja e nënshkrimeve duhet të bëhet mbi bazën e vullnetit të lirë të anëtarëve. Ndalohet ushtrimi i çfarido presioni apo ndikimi që imponon, kushtëzon apo detyron qytetarët për të nënshkruar pa vullnetin e tyre, apo nënshkrimin në emrin e tyre.

Neni 61

Inicimi i procedurës

1. Anëtarët e njësisë zgjedhore të interesuar për iniciimin e procedurës së largimit të anëtarit të Kuvendit nga sjo zonë, duhet të themelojnë një grup nismëtar. Grupi nismëtar përbëhet nga tre (3) ose më shumë anëtarë me të drejtë vote në atë njësi zgjedhore.
2. Grupi nismëtar, para se të fillojë me mbledhjen e nënshkrimeve në mbështetje të kërkesës, duhet të njoftojë Kryetarin e OFK-së mund të njoftojë KQZ. Kryetari i OFK-së njofton KQZ. Njoftimi përfshin përbërjen e grupit nismëtar, definimin e çështjes dhe arsyetimin e kërkesës.
3. Jo më vonë se pesë (2) ditë nga regjistrimi i grupit nismëtar, Kryetari i OFK-së kërkon nga KQZ numrin e përditësuar të votuesve të regjistruar për njësinë përkatëse zgjedhore, mbi bazën e të cilit përllogaritet numri minimal i nevojshëm i nënshkrimeve prej 1/3 e anëtarësisë së asaj njësie zgjedhore.
4. Numri minimal prej 1/3 e amëtarëve nënshkrues, llogaritet sipas numrit përgjithshëm të votuesve në listën e përditësuar të njësisë përkatëse zgjedhore, që mbanë datën njoftimit në kërkesë.
5. Jo më vonë se pesë (7) ditë nga regjistrimi i grupit nismëtar, shërbimi profesional i OFK-së, pajis grupin nismëtar me dokumentacionin e nevojshëm. Dokumentacioni përfshin listën e nënshkrimeve në formatin e përcaktuar sipas KQZ, si dhe listën e votuesve të aprovuar nga KQZ që përfshin listën deri datën e paraqitjes së kërkesës në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe me numrin minimal të nevojshëm për këtë proces.
6. Lista e nënshkrimeve sipas paragrafit 5 të këtij neni, përmban në secilën faqe të saj të dhënat si në vijim:

6.1. Titullin e kërkesës;

6.2. çështjen për të cilën mblidhen nënshkrimet;

6.3. tabelën me këto të dhëna:

6.3.1. Emrin;

6.3.2. mbiemrin;

6.3.3. numrin personal;

6.3.4. Kodi i licencës

6.3.5. numrin e telefonit;

6.3.6. nënshkrimin.

7. Për mbledhjen e nënshkrimeve, grupi nismëtar përdorë listën e nënshkrimeve sipas formatit të përcaktuar nga KQZ.

Neni 62

Mbledhja, dorëzimi dhe verifikimi i nënshkrimeve

1. Grupi nismëtar, brenda tridhjetë (30) ditëve nga pajisja me dokumentacionin e nevojshëm, duhet të mbledhë numrin e kërkuar të nënshkrimeve. Ky afat mund të shtyhet vetëm njëherë, me kërkesë të grupit nismëtar edhe për pesëmbëdhjetë (15) ditë tjera.
2. Nënshkrimet mblidhen në format fizik.
3. Një anëtarë i cili ka nënshkruar në listën inicuese, mund të tërheq nënshkrimin e tij, përmes deklaratës me shkrim në mënyrë fizike së bashku me arsyetimin e tërheqjes, jo më larg se brenda 6 ditëve nga dorëzimi i listës nga grupi inicues, apo 24 orësh nga njoftimi i KQZ-së që i ka bërë për verifikim të listës.
4. Grupi nismëtar përgatitë dosjen e kërkesës me nënshkrime dhe ia dorëzon Komisionit Qëndror të

Zgjedhjeve .

5. KQZ, verifikon listën e nënshkrimeve brenda 8 ditëve nga pranimi i saj. Pas verifikimit të nënshkrimeve, KQZ njofton Kryetarin e OFK-së dhe grupin nismëtar jo më larg se 3 ditë nga përfundimi i vlerësimit, me vlerësimin përfundimtar për validitetin e kushtit për nënshkrime për mbajtjen e procesit për Shkarkimin e mandatit.
6. Verifikimi i listës nga KQZ bëhet nga sekretariati përmes thirrjes telefonike të anëtarit nënshkrues, apo deklarimit me email.
7. Nëse nga verifikimi i listës me nënshkrime, KQZ konstaton se nuk është plotësuar numri minimal prej 1/3 të votuesve të regjistruar, atëherë KQZ njofton grupin nismëtar, të cilit i jepet mundësia e plotësimit të kërkesës me nënshkrime në afatin shtesë prej dhjetë (10) ditësh. KQZ, për afatin shtesë e njofton kryetarin e OFK-së.
8. Nëse edhe pas afatit shtesë për plotësimin e numrit të nënshkrimeve, nuk përmbushet kushti prej së paku 1/3 të votuesve të regjistruar, KQZ konstaton se kërkesa nuk është mbështetur nga numri i nevojshëm i votuesve dhe konsiderohet e pavlefshme. Për këtë, KQZ njofton grupin nismëtar dhe Kryetarin e OFK-së.
9. Pas verifikimit dhe konstatimit se kërkesa është mbështetur nga së paku 1/3 e anëtarëve të regjistruar, KQZ njofton grupin nismëtar dhe Kryetarin e OFK-së.
10. Në rast se konstatohet se kërkesa është mbështetur nga së paku njëzet 1/3 e anëtarëve të regjistruar organizohet votimi për largimin e anëtarit të Kuvendit nga detyra i cili vie nga ajo njësi zgjedhore.

Neni 63

Organizimi i procesit të votimit

1. Pas konstatimit të plotësimit të numrit të nënshkrimeve për incim të procedurës për Shkarkimin e mandatit të anëtarit të Kuvendit, organizohet procesi zgjedhorë për deklarim të anëtarëve.
2. Në proces zgjedhorë anëtarët deklarohen në pyetje "Deklarohuni nëse mbështetëni iniciativën e grupit incues për Shkarkimin e mandatit të z. _____, nga pozita e anëtarit të Kuvendit të OFK-së nga njësia e juaj zgjedhorë.
3. Anëtarë mund të zgjedh një nga tri alternativat e përgjigjes : a. PËR, b. Kundër, c. Abstenim
4. Procesi i votimit organizohet përshtatshmërisht me rregullat për organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme.
5. Mandati i anëtarit të Kuvendit, konsiderohet i revokuar në rast se për Shkarkimin e tij PËR kanë votuar $\frac{1}{2}$ +1 anëtarë të certifikuar në listën votuese për këtë proces.
6. Anëtarë i revokuar, zëvendësohet nga anëtarët e radhës të mbetur nga lista e certifikuar e rezultateve në zgjedhjet e rregullta të mbajtura për Kuvendin e OFK-së.
7. Në rast se nuk ka asnjë kandidatë të mbetur në radhë, organizohet proces i ri zgjedhorë për atë vend të mbetur në njësinë zgjedhore përshtatshmërisht me dispozitat për organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme.

Neni 64

Deklarimi i mosbesimit/shpërbërjes të tërësishme të Kuvendit

1. Me iniciimin e 1/4 së anëtarëve të përgjithshëm të OFK-së në kohën e inicimit, mund të fillohet procedura për deklarim të mosbesimit përkatësisht shpërbërjen e tërësishme të Kuvendit të OFK-së.
2. Procedura e deklarimit dhe organizimit të këtij procesi rregullohet përshtatshmërisht me dispozitat e Statutit dhe dispozitat e kësaj rregullore përkthazi me Shkarkimin e mandatit të anëtarit të Kuvendit nga njësia zgjedhore.

Neni 65
Shkarkimi i mandatit të Kryetarit të OFK-së

Kuvendi i OFK-së, mund ta shkarkojë Kryetarin e OFK-së para përfundimit të mandatit për arsyet dhe në procedurën e përcaktuar si në nenin 29 të Statutit të OFK-së.

Neni 66
Shkarkimi i mandatit të zv. Kryetarëve të OFK-së

Kuvendi i OFK-së, mund të shkarkojë zv. Kryetarët e OFK-së pas propozimit të Kryetarit të OFK-së, me shumicën e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

Neni 67

1. Shkarkimi i anëtarëve të organeve (Këshilli Drejtues, Këshilli Mbikqyrës, Këshilli Etik, Gjyqi i Nderit, Prokurori i OFK-së)
2. Kuvendi i OFK-së, mund ta shkarkojë Kryetarin e OFK-së para përfundimit të mandatit për arsyet dhe në procedurën e përcaktuar si në nenin 49 të Statutit të OFK-së.

Neni 68

1. Shkarkimi i anëtarëve të komisioneve të zgjedhura nga Kuvendi
2. Kryesuesi i komisionit, apo ½ e anëtarëve të Komisionit mund t'i paraqesin këshillit drejtues kërkesë për shkarkimin e anëtarëve të Komisionit.
3. Kuvendi i OFK-së, mund të shkarkojë një anëtarë të Komisioneve të OFK-së të zgjedhura nga Kuvendi, vetëm me propozimin e Këshillit Drejtues të OFK-së.
4. Votimi konsiderohet i sukseshëm nëse për të kanë votuar shumica e anëtarëve të Kuvendit të pranishëm në mbledhje.

Pezullimi i anëtarit të organit kolegjiale nga funksioni

Neni 69

1. Në rast kur ndaj një anëtari të organeve të OFK-së, fillon procedura etike pranë organeve kompetente të OFK-së, apo procedurë gjyqësore për keqpërdorim të detyrës profesionale apo detyrës zyrtare, Kryetari OFK-së automatikisht pezullon nga detyra anëtarin.
2. Në mbledhjen e parë pas pezullimit të anëtarit, Kuvendi OFK-së vendos nëse i njëjti do të mbetet i pezulluar deri në përfundimin e çështjes etike apo gjyqësore, apo do të shkarkohet dhe në vend të tij të zgjidhet anëtar tjetër.
3. Fillim i procedurës etike konsiderohet dorëzimi i fletparaqitjes apo pezullimit të procedurës së prokurorit në Këshill Etik apo subjektit tjetër të përcaktuar me Ligj.
4. Pezullimi nga detyra, nuk paragjykon fajësinë e anëtarit në fjalë

KREU XX
PROCEDURAT PËR VËZHIM, AKREDITIMI DHE AUTORIZIMET E VËZHguesve

Neni 70
Propozimi i vëzhguesve

1. Secili kandidatë i cili merr pjesë më procesin zgjedhor ka të drejtë që të propozojë një person në cilësi të vëzhguesit në njësinë zgjedhore në të cilën është certifikuar kandidatura e tij.
2. Kandidati mund ta propozojë vëzhguesin vetëm brenda njësisë zgjedhore në të cilin zgjedhet nga anëtarët e njësisë zgjedhore. Vëzhguesi nuk mund të jetë kandidatë për anëtarë të Kuvendit.
3. Për të propozuar vëzhguesin kandidati duhet që të parashtrojë kërkesë pranë KQZ-së së bashku me formularin për kandidim dhe jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas certifikimit përdunimtarë të kandidatëve.
4. Anëtar i Kuvendit i cili kandidon për ndonjërin prej organeve të OFK-së, mund ta propozojë një nga anëtarët e Kuvendit për vëzhgim të procesit ku ai kandidon gjatë mbajtjes së asaj mbledhje. Rregullat e përcaktuara për vëzhguesit gjatë procesit zgjedhorë për Kuvendin e OFK-së janë të barazvlershmër edhe për vëzhguesit gjatë procesit të organeve që dalin nga Kuvendi i OFK-së.

Neni 71
Kërkesat e organizatave për akreditim

1. Organizatat joqeveritare që shprehin interes për të përcjellë procesin zgjedhor në OFK, kanë të drejtë që të parashtrojnë kërkesën për akreditim nga dita kur zgjedhjet për Kuvendin e OFK-së të jenë shpallur nga KQZ-ja.
2. Kërkesat nga paragrafi 1 i këtij neni duhet parashtuar pranë KQZ-së jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.
3. Organizatat joqeveritare që e parashtrojnë kërkesën për akreditim kanë të drejtë që të propozojnë nga një përfaqësues në cilësi të vëzhguesit për një vendvotim.

Neni 72
Akreditimi i vëzhguesve dhe organizatave

1. KQZ-ja do të akreditojë organizatat joqeveritare dhe vëzhguesit e kandidatëve jo më vonë se 5 (pesë) ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.
2. Me rastin e akreditimit të vëzhguesit dhe organizatave joqeveritare, KQZ-ja do ta nxjerrë listën e vëzhguesve dhe organizatave të akredituara për secilin vendvotim. Lista e tillë do t'i dërgohet KNJZ-ve.
3. Në listën nga paragrafi 2 i këtij neni KQZ-ja do të shënojë të dhënat e secilit përfaqësues të një organizate që ka parashtuar kërkesën për akreditim, duke specifikuar vendvotimin për të cilin është akredituar përfaqësuesi i organizatës së akredituar.
4. Në qoftë se kërkesat e kandidatëve apo të organizatave joqeveritare, nuk përmbushin kushtet e përcaktuara nga KQZ me rastin e thirrjes për vëzhgim, KQZ-ja do të refuzojë akreditimin e tyre.
5. Palët e interesuara kanë të drejtë të parashtrojnë kundërshtim pranë KQZ-së.
6. Ndaj vendimit të KQZ-së mbi kundërshtimin mund të paraqitet ankesë në Gjyqin e Nderit.
7. Vendimi i Gjyqit të Nderit është përfundimtar.
8. Afatet procedurale për realizimin e të drejtave nga ky nen përcaktohen nga KQZ.

Neni 73
Të drejtat e vëzhguesve të akredituar

1. Vëzhguesit e akredituar, duke përfshirë vëzhguesit e propozuar nga kandidatët apo përfaqësuesit e organizatave të akredituara, nga ora kur hapet vendvotimi e deri në përfundimin e numërimit të votave pranë KNJZ-ve kanë këto të drejta:
 - 1.1. të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës nga hapja dhe mbyllja e vendvotimit e deri në përfundimin e numërimit të votave në KNJZ;
 - 1.2. të vëzhgojnë çdo veprim të komisionerëve dhe të vrojtojnë mënyrën e punës në vendvotim;
 - 1.3. të vëzhgojnë mënyrën e identifikimit të votuesve nga Lista e Votuesve;
 - 1.4. të mbajnë shënime lidhur me ecurinë e procesit në vendvotim;
 - 1.5. të jenë të pranishëm në rastin e plotësimit të procesverbalit të vendvotimit; dhe
 - 1.6. të paraqesin vërejtjet e tyre në Librin e Votuesve;
2. Në rast se vëzhguesi i kandidatit nuk ka shënuar vërejtjen e tij në Librin e Votuesve, kandidati në ankesën e tij nuk mund ta bazojë pretendimin në dëshmitë e vëzhguesit i cili ka qenë i akredituar sipas propozimit të tij.

Neni 74
Ndaletat dhe përmbajtja e vëzhguesve

1. Vëzhguesit dhe përfaqësuesit e akredituar gjatë procesit zgjedhor nuk kanë të drejtë të realizojnë çfarëdo komunikimi me votuesit.
2. Vëzhguesit nuk duhet të ndërmarrin asnjë veprim përmes së cilit do të ndikojnë në vullnetin e lirë të votuesve.
3. Gjatë qëndrimit në vendvotim vëzhguesi të jetë i pajisur me mjet identifikues të lëshuar nga KQZ-ja.
4. Në çdo rast kur cilido komisioner vëren që vëzhguesi nuk i përmbahet rregullave të vendvotimit, vërejtjen e tillë do ta shënojë në Librin e Votuesve dhe për këtë do ta njoftojë kryesuesin e vendvotimit. Kryesuesi i vendvotimit duhet t'ia tërheq vërejtjen vëzhguesit për sjelljet e tilla dhe në rast të përsëritjes ai duhet të kërkojë largimin e vëzhguesit nga vendvotimi.

Neni 75
Ankesat nga vëzhguesit dhe organizatat e akredituara

1. Vëzhguesi dhe organizatat e akredituara kanë të drejtë që të parashtrorjnë kundërshtime lidhur me parregullsitë që i evidentojnë në vendvotimin e KNJZ- së pranë të cilës janë akredituar.
2. Kundërshtimet nga paragrafi 1 i këtij neni i parashtrorhet KQZ-së në një afat brenda njëzet e katër (24) orëve nga mbyllja e vendvotimit. KQZ-ja duhet të vendosë për kundërshtimet e parashtruar në afat brenda prej njëzet e katër (24) orëve nga ora e parashtrimit të ankesës.
3. Kundër vendimit të KQZ-së mbi kundërshtimin, mund të paraqitet ankese të Gjyqi i Nderit i cili merr vendim përfundimtar.
4. Afatet procedurale për realizimin e të drejtave nga ky nen përcaktohen nga KQZ.

KREU XXI DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 75 Sanksioni etike

1. Ndaj kandidatët për anëtarë të organeve të OFK-së të cilat cenojnë procesin zgjedhorë për organe të OFK-së ose nuk respektojnë parimet e përcaktuara me këtë rregullore, shkeljet e tilla do të shërbejnë si bazë për iniciimin e procedurës etike për shkelje të rëndë të detyrimeve
2. Po ashtu edhe ndaj anëtarëve votues të cilët veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregullore, shkeljet e tilla do të shërbejnë si bazë për iniciimin e procedurës etike për shkelje të rëndë të detyrimeve
3. Procedura e vërtetimit të shkeljes së pretenduar zbatohet përshtatshëmrisht me dispozitat e rregullorës për përcaktimin e shkeljeve etike dhe procedurat e mbikqyrjes etike dhe profesionale të OFK-së.
4. Ndaj rasteve nga paragrafi I dhe II i këtij neni mund të shqiptohet njëra nga masat e parapara (Paragrafi I me nënparagrafin 6 ose masa në nënparagrafin 7) në nenin 25 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësore 04/L-150, në varësi nga rrethanat e shkeljes.
5. Shkelja etike nuk konsumon veprën penale.

KREU XXII DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 76 Kontinuiteti i punës së organeve të OFK-së

1. Organet e OFK-së nga përbërja aktuale e Kuvendit, vazhdojnë punën deri në konstituimin e organeve nga përbërja e re e Kuvendit.
2. Dëshmitë mbi të kaluarën etike dhe penale nuk dihet të jenë më të vjetëra se 60 ditë nga dita e kërkesës.

Neni 77

1. Asnjë procesverbal i KQZ-së, KNJZ-së ose i një komisioni tjetër zgjedhor nuk mund të asgjësohet pa miratimin paraprak të KQZ-së.
2. Fletët e votimit dhe materialet e tjera zgjedhore ruhen në ambientet e Odës deri në përfundim të mandatit.
3. Të gjitha fletët e votimit asgjësohen sipas mënyrës së përcaktuar nga KQZ-ja.

Neni 78 Hyrja në fuqi

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohen dispozitat e rregullores për organizimin e zgjedhjeve, procedurën e kandidimit, mënyrën e zgjedhjes dhe Shkarkimin me anëtarëve të organeve të Odës së Farmacistëve të Kosovës me nr. Prot. 101-1 të datës 23/04/22 dhe rregulloreve tjera të cilat janë në kundërshtim me këtë rregullore.
2. Çështjet të cilat nuk janë të parapara me këtë rregullore dhe legjislacionin e OFK-së, rregullohen nga KQZ në përputhje me standardet, kërkesat dhe praktikën ndërkombëtare.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi nga 1 Janari 2025

Prishtinë 14/12/2024

Kryetari i OFK-së
Mr.Ph. Kadri Bytyqi

